



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Drenasit**  
**Zyra e Kryetarit**



01- Nr 020/04. 21015 dt. 19. 06 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 12-464/01-16598, i datës 27.05.2020, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit Nr.12-464/01-16598, të datës 27.05.2020, për Shpalljen e Interesit Publik**

- I. Anëtarët e komisionit për hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit Nr.12-464/01-16598, të datës 27.05.2020 janë:
  1. Safet Hoxha, gjeodet ( kryetar),
  2. Granit Hasanaj, jurist ( anëtar),
  3. Fadil Tahiri, gjeodet ( anëtar).
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.12-464/01-16598, të datës 27.05.2020, për rifunksionalizimin e burimit të ujit dhe rezervarit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
- III. Ky komisioni, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim, si dhe në një afat të arsyeshëm të dorëzojë hartimin e Elaboratit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

  
Kryetari i Komunës  
**Ramir Lladrovci**

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- DGJKP-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.